



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 24.07.2019, ora 16.00

**Drejton mbledhjen -**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

1. *Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

2. *Caktimi i ekspertit auditues ligjor të licencuar për dhënien e mendimit teknik lidhur me analizën financiare të nevojshme për disa aspekte të verifikimit të pasurisë së një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                     |                     |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani   | (kryetar)           |
| 2. Vitore Tusha     | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)           |
| 4. Fatri Islamaj    | (anëtar)            |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare)           |
| 6. Fatjona Memçaj   | (anëtare)           |
| 7. Eriol Roshi      | (anëtar)            |

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni 232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm :**

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

**HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.*

*Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.*

*Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:*

*Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

*Caktimi i ekspertit auditues ligjor të licencuar për dhënien e mendimit teknik lidhur me analizën financiare të nevojshme për disa aspekte të verifikimit të pasurisë së një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.*

Numri i rasteve për shqyrtim është 16, prej të cilave për 6 kandidatura relatimi Këshilli ishte tërhequr për të marrë vendimet përkatëse dhe në thelb vlerësoi që të shtyjë vendimmarrjen edhe për to, në mënyrë që për shkak të disa mangësive tona në përcjelljen e dokumentacionit, ti jepej mundësia e Avokatit të Popullit të përgatisë mendimin për secilën nga kandidaturat e herës së kaluar. Në shqyrtimin e këtyre rasteve do të fillohet me parashtrimin e mendimeve që mund të ketë përfaqësuesi i Avokatit të Popullit.

Ka edhe një sugjerim për të shtuar në rendin e ditës një pikë nga dy relatorët Arta Marku dhe Eriol Roshi lidhur me kandidaturat e znj. Zhaklina Peto. Është vlerësuar që duhet të kryhet një ekspertim meqenëse nga ballafaqimi i dokumentacionit lind nevoja për të pasur edhe një analizë financiare për të verifikuar burimet e mjaftueshme.

Gjithashtu ka edhe një kërkesë ose një njoftim nëpërmjet emailit nga zoti Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës që kërkon të shfaqë disa opinione lidhur me procedurat e verifikimit.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** me shqyrtimin e gjetjeve për rastet e kandidatëve që janë kandiduar për vende vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, duke u orientuar përfaqësuesi i avokatit të Popullit të marrë fjalën dhe të parashtrojë problematikën që sipas vlerësimit të tyre rezultoi në procedurat e verifikimit të kandidatëve që ky Këshill i ka relatuar në mbledhjen e kaluar.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avoaktit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se pavarësisht ngarkesës duhen të respektohen rregullat për shpalljen. Ditën e Premte, përtej orarit zyrtar na u sollën 9 dosje, të kandidatëve Arta Vorpsi, Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Anila Kristani, Besnik Muçi, Ilir Mustafaj, Artur Malaj, Rexhep Bekteshi. Ditën e Hënë, rreth përfundimit të orarit zyrtar na u sollën dosjet e kandidatëve Dede Kasneci, Mimoza Qinami dhe ditën e djeshme nga ora 16.40, u sollën 4 dosjet e fundit për kandidatët Altin Hazizaj, Gëzim Allaraj, Vladimir Gërmenji dhe Eris Hysi.

Po të keni parasysh që një dosje ka mijëra faqe, bëhet fjalë për 20 mijë. Dosjet ishin të painventarizuara. Vetë protokollit pati probleme sipas rregullave të protokollit për ti protokolluar. Nga verifikimi mund të kishte mungesë të dokumentave që teorikisht ose kandidati nuk i ka dorëzuar ose neve nuk na janë përcjellë. Do ti evidentojmë kur të jetë rast pas rasti kandidati përkatës se cilat dokumente na mungojnë. Kjo na i bën shumë të pamundur dhënien e një opinioni të plotë për secilën kandidat. Duke qenë se tashme e kemi të gjithë dokumentacionin, ne i kemi ndarë momentet tona në dy pjesë. Probleme të përgjithshme që i kemi konstatuar pothuajse në secilën nga dosjet e kandidatëve dhe pastaj ka dhe probleme individuale që ka secili kandidat.

Do e nisja së pari për gjetjet tona për procedurën e përgjithshme, pra duke ju referuar relacionit. Relacioni është sjellë me email më parë ndërkohë në dosje janë sjellë më vonë. Nuk jemi të qartë nëse këto dosje i janë dhënë anëtarëve në të njëjtën periudhë me institucionit tonë apo i kanë marrë në një kohë të mëparshme.

Së pari, në pikën një të të gjitha relacioneve parashikohet se Këshilli vihet në lëvizje pas përcjelljes së dokumentave nga organi i emërtesës. Në pikën 2 parashikohet se në

përfundim të procedurës së aplikimeve ia kanë dërguar dokumentacionin Këshillit, por ne na mungon. Mungon edhe shkresa përcjellëse e tyre e cila ka rëndësi pasi lidhet me afatet për fillimin e procedurës. Pra në pikën 2 të çdo relacioni thuhet është përcjellë por nuk thuhet data kur këto materiale janë depozituar pranë KED.

Avokatit të Popullit i janë vënë në dispozicion dokumentet të pjesshme. Pra, dokumentet që kanë lidhje me individin dhe që do të më jepnim të kuptonim nëse përmbushen apo jo kriteret e parashikuara në nenin 7/a të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si librezë pune, diplomë, këto janë të parashikuara në ligj. Nuk e dimë nëse kandidati i ka dorëzuar pranë organit apo nuk i ka dorëzuar. Edhe në vendimin nr. 4 të KED thuhet se Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori i veprimeve të kryera të tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Nuk e di, domethënë, normalisht relatori e ka pasur dosjen e plotë në momentin që ka përgatitur relacionin.

Ka një moment tjetër, që ne mendojmë që është shumë i rëndësishëm dhe që lidhet me afatet dhe komunikimin e relatorit dhe kryetarit të KED-së. Nuk ka një dokument përcjellës, email apo shkresë në çfarë mënyre e përcjell për të përcaktuar datën. Sipas nenit 239 të ligjit por dhe pikës 33 të vendimit nr.4 sapo lexova, nga ky moment fillojnë afatet. Pra, kryetarit i fillojnë afatet për thirrjen e mbledhjes dhe fillojnë afatet e tjera për kandidatët për dorëzimin e dokumentacionit. Donim të dinim që kur u është dërguar dosja anëtarëve të tjerë të këtij organi dhe në çfarë mënyre ju është dërguar.

Problem tjetër është struktura e relacionit. Ne e përmendëm dhe herën e kaluar që mungon pjesa e gjetjeve, analizës. Relacioni është një përcjellje thjesht e informacionit që kemi çuar këtë shkresë dhe ka ardhur kjo përgjigje. Në vlerësimin tonë ligji nuk parashikon një gjë të tillë. Neni 228 pika 5 parashikon që relatori për zhvillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe renditjes kryen detyrat e mëposhtme: Shqyrtimin, verifikimin, kontrollin e pasurisë, përgatitjen e projektvendimit etj, etj. Pra, ai bën vlerësim, në relacion mungon vlerësimi, nuk ka analizë. A duhet të japin relatorët një opinion nëse kandidati e plotëson apo jo një kriter ? Pra, ne nuk kuptojmë nëse kriteri është plotësuar apo jo dhe duke mos pasur një pjesë të madhe të dokumentave personale e kandidatit, nuk arrijmë të plotësojmë detyrimin tonë ligjor. Jemi këtu për ta parë realizimin e transparencës të organit dhe duke mos e pasur këtë lloj analize, duke mos pasur dokumentacion, ne mendojmë që kjo sjell një ulje të transparencës.

Çështje tjetër që është e paqartë në të gjitha relacionet janë mekanizmat e përdorura nga organi, nga relatori për verifikimin e disa kriterëve. Le të marrim kriterin e ushtrimit të funksioneve politike që thotë 10 vjetët e fundit kandidati mos të ketë mbajtur funksionet

drejtuese në organet e partive politike. Ndërkohë zgjedhjet e fundit kanë qenë 4 vjet, por organi është kufizuar vetëm në pjesën e zgjedhjeve parlamentare e jo të zgjedhjeve vendore. Jo të gjitha partitë kanë kthyer përgjigje. Na jepet vetëm shkresa përcjellëse në të cilën bashkëlidhet vetëm lista e partive. Pra, duke patur këtë lloj mungese informacioni nuk mund të japim një mendim nëse është e realizuar apo jo e plotë procedura për verifikimin e këtij kriteri. P.sh ishte një kandidat që kishte qenë 8 vjet jashtë shtetit. Një kandidati që ka jetuar dhe punuar në Shqipëri i kërkojmë dëshmi penaliteti nga Shqipëria, ndërkohë që po ka jetuar jashtë duhet të kërkohet i njëjti dokument. Sigurisht mund ti lihet një kohë më e gjatë, se marrja e një dokumenti të tillë kërkon më tepër kohë. Nga praktika ka pasur edhe anëtar të Gjykatës së Lartë apo deputet të cilët kanë pasur të kaluar për të fshehur dhe më pas ka dalë një gjë e tillë.

Çështje tjetër është që janë edhe kandidatë të cilët janë në procesin e Vetingut. Ne rekomandojmë që për këta persona procesi të pezullohet, gjë që parashikohet nga neni 66 i Kodit të Procedurës Administrative i cili thotë “ kur një çështje është e lidhur me një çështje tjetër atëherë do të presim mbarimin e kësaj çështje”. Ankimi i Komisionerit Publik në vlerësimin tonë është një dokument mjaft i rëndësishëm. Të bëjmë diferencën e vendimeve gjyqësore me organet e administratës publike. Përsa kohë që vendimi i KPK ose nuk ka marrë formë të prerë s ose është ankimuarj apo për më tepër që janë rrëzuar, ne mendojmë që për këta persona duhet të pezullohet shqyrtimi i mëtejshëm, duhet pritur përfundim të procesit. Një gjë e tillë është në zbatim të nenit 7/a pika 1/dh për Gjykatën Kushtetuese, i cili parashikon që kandidati të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit etj.. Këtu kuptohen të dy fazat e Vetingut, pra jo vetëm KPK por edhe KPA. Ndoshta edhe pika 112 e vendimit nr.4 të KED mund të rishikohet në këtë frymë. Njëkohësisht edhe organet e tjera të drejtësisë siç është KLP-ja, ka ndjekur pikërisht këtë standard, kanë bërë intervistimin e kandidatëve dhe kanë pezulluar procesin.

Një moment tjetër, që për ne është i paqartë është si kanë proceduar relatorët me 11 deklaratimet negative të ILDKPI –së sepse një gjë e tillë nuk del nga relacioni. Në disa dosje rezultojnë që kandidatëve ju janë vënë në dispozicion raportet e ILDKPI-së dhe kanë dhënë shpjegimet përkatëse. Në rastin e një kandidate i është kërkuar për herë të dytë të japë shpjegime. Ne na erdhi dosja në orën 5 pa 10, arritëm që ta shfletonim kështu si figurat që shikojnë kalamjtë se nuk kishim kohë. Mos na keqkuptoni, e vlerësojmë shumë punën tuaj.

Ne kemi vullnetin tonë maksimal, pavarësisht ngarkesës, u ngarkuam me këtë detyrë, të jemi anëtar në këtë organ të nderuar dhe nuk na u dha as buxhet shtesë, as staf shtesë, gjë

që ja u kemi bërë me dije edhe Parlamentit edhe instancave të tjera sepse realisht fizikisht koha është e pamjaftueshme.

Edhe dokumentacioni qa na ka ardhur është i ndryshëm nga ILDKPI-ja. Dosja e ILDKPI-së është një CD që na është vënë në dispozicion. Protokollin nisi të bënte pikërisht këtë gjë dhe në mbledhjen e kaluar kërkuam minimalisht të kemi të plotësuar punën e të dy palëve, të kemi një listë inventari të dosjes. Kërkohej nga instancioni ynë që ne për një javë të shqyrtojmë. Pra, administrata e KED-së nuk pati kohë fizike për të fotokopjuar dhe për të na e sjellë dhe për të na lënë minimalisht 24 orë kohë për të parë dosjet, flas për 4 kandidaturat e fundit. Edhe të shtunë edhe të dielë kemi lënë çdo gjë, familjen dhe gjëra të tjera dhe kemi punuar në kushtet e emergjencës për aq sa njerëz sa mund të angazhohemi sepse në materialet që na keni përcjellë thuhet bëhet fjalë për dokumentat konfidenciale. Dhe jo kujtdo mund ti besohet. E dyta, jemi më 24 Korrik dhe gati gjysma e stafit janë me pushime. Ne kemi ngritur një grup pune menjëherë ditën e Premte sa erdhën këto dhe filluam shqyrtimin e dokumentacionit.

Për tu rikthyer argumentit që ishim tek ILDKPI-ja, pra, si ka proceduar relatori pasi një gjë e tillë nuk del në relacion. Në vlerësimin tonë në momentin që është konstatuar një opinion negativ do të duhet që relatori të shprehte mendimin e tij dhe ti kërkonte organit në rast se ai do ta mendonte, po themi që ka nevojë për një ekspertizë ekonomike. Ose një variant tjetër mund të ishte p.sh ILDKPI-së, si organ i specializuar mund ti kërkohej mendim edhe mund ti thonit kandidati ka paraqitur këto prapsime, këto pretendime. Më pas mund të ballafaqohej dhe pastaj organi e kishte me të lehtë për të vepruar dhe për të proceduar më tej.

Ose marrim rastin e kundërt. Organet e vetingut edhe në rastet kur informacioni nuk ka qenë negativ nga ILDKPI-ja kanë vendosur të mos e marrin parasysh. E njëjta gjë mund të ndodhi edhe me KED-në. Ne rastin kur ILDKPI-ja ka dhënë relacion pozitiv, a do ti futet organi këtij relacioni pozitiv?. Pra, çfarë analize ka bërë relatori që ka thënë po plotësohen kushtet për të kaluar më tej në seancë.

Gjithashtu, ligji parashikon që pasi përfundon faza e verifikimit, në fazën tjetër të vlerësimit ka në sërë kriteresh që do të verifikohen nga organi. Pyetja lind a do të kërkohej dokumentacion shtesë apo ky është i gjithë dokumentacioni që kandidati ka dorëzuar. Kjo ishte e paqartë nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion..

Këto ishin disa gjetje që i kemi konstatuar në të gjithë kandidatët që patëm mundësi ti shqyrtonim. Këto ishin të përgjithshme. Përsa i përket pjesës së veçantë pastaj rast pas rasti do të ndalemi në komentet e secilit.

*Anëtarët e Këshillit*, në lidhje me parashtrimet e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, në thelb, shprehin qëndrimin dhe i sjellin në vëmendje se në mënyrë të përsëritur deklarohet që afatet e sjelljes dhe koha për përgatitje e shqyrtim të dokumentacionit është e pamjaftueshme, por duhet të mbajë parasysh se Avokati i Popullit është institucion me strukturë, organikë dhe administratë mbështetëse e cila mund të angazhohet dhe punojë me intensitet, sikurse po bën KED. Synimi i KED është të zhvillojë procedurat e të punojë me cilësi dhe shpjëtesë, aq më tepër në kushtet kur, aktualisht dhe prej shumë kohësh, në Gjykatën Kushtetuese janë të gjitha vendet vakante, sikurse edhe ai i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Edhe relacionet, p.sh., me gjetje pozitive apo negative dhe propësimet eventuale të kandidatëve janë vënë në dispozicion prej kohësh, ku përmenden edhe të dhëna të hollësishme nga raportet, janë dërguar edhe dosjet e plotë me raportin dhe dokumentacionin e ILDKPKI (me CD), si dhe tani edhe kontrollet e KED, secila prej tyre prej qindra e qindra faqesh.

Po kështu, në secilin rast është e qartë dhe evidente që secilit kandidat i është bërë e njohur raporti i ILDKPKI dhe secili prej tyre ka dërguar pranë KED qëndrimet dhe shpjëgimet e tij kur gjetjet e tyre janë negative, përfshirë edhe në rastet kur relatorët kanë vlerësuar tu drejtojnë pyetje shtesë për shpjëgime shtesë.

Nga ana tjetër, KED i ka përcjellë Avkatit të Popullit material dhe dokumentacion më shumë se sa ka qenë i detyruar sipas rregullave të procedurës, duke i dërguar praktikisht pjesën dërmuese të dosjes së plotë të secilit kandidat. Pra, KED duket se kritikohet përse nuk ka përcjellë gjithshka edhe pse nuk është i detyruar. Ndonëse nga KED janë dërguar materiale më shumë se sa është i detyruar, përsëri deklarohet nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit se nuk jeni transparent. Nëse vërtet mund të mungojë aty ndonjë element procedural, sigurisht kjo nuk është bërë me qëllim dhe nuk është motiv për të penguar ecurinë e proceseve.

Sipas procedurës, KED informon për veprimet e kryera dhe përgjigjet e marra, përcjell aktet për këto veprime që ka kryer relatori, por jo edhe përgjigjet e ardhura. Ndërkohë KED çmoi të dërgojë pranë Avokatit të Popullit material sa më të plotë, përfshirë edhe pjesën dërmuese të përgjigjeve. Ndër të tjera nuk mund të jepen dhe as mund të kërkohen dokumentet që mundet të jenë të klasifikuara si konfidenciale apo sekret. Edhe kjo shkon përtej asaj që lejohet për dhënien nga Avokati i Popullit të mendimeve vetëm për mënyrën e ndjekur në realizimin e procedurës së verifikimit, nëse KED ka vepruar ose jo, nëse i ka garantuar kandidatit mundësinë të njihet me aktet dhe të japë shpjëgime. Madje, sipas rregullave të procedurës, Avokatit të Popullit nuk i lejohet të japë mendim nëse

kandidati është i vlefshëm apo jo, duhet të ndalohet apo jo nga kandidimi. Ndonëse KED vlerësoi të përcjellë shumë më tepër akte dhe të dhëna se sa detyrohej, Avokati i popullit është paralajmëruar që të mbajë parasysht urdhërimet sipas legjislacionit që këto dhëna të mirëadministrohen dhe mos keqpërdoren.

Nga ana tjetër, dosja e kandidimit kur të dërgohet sipas kërkesës në organin e emërteses do të jetë e plotë, e organizuar, me inventar, numërtime etj. sikurse nevojitet në komunikimin zyrtar ndërmjet institucioneve. Ndërsa në këtë rast, duke qenë se është pjesëmarrëse në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm sipas ligjit, dokumentet e dërguara Avokatit të Popullit janë thjesht dhe vetëm materiale pune të rendit të ditës, të dërguara në trajtën e dokumente të fotokopjuara, sikurse veprohet rëndom me njohjen e pjesëmarrësve të mbledhjeve me materialet e rendit të ditës.

Ndërsa pjesa tjetër e dokumentacionit, e dorëzuar nga kandidatët dhe që lidhet me fazën tjetër të vlerësimit dhe pikëzimit të tyre, si edhe veprimet procedurale përkatëse të relatorit, me të njëjtën qasje si tani, do të dërgohet edhe Avokatit të Popullit kur të fillojë ajo fazë.

**Ardian Dvorani** i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të vijojë me qëndrimet konkrete për procedurën e ndjekur për secilin nga kandidatët, duke filluar me ata që KED i ka relatuar në mbledhjen e kaluar. Së pari për kandidatin Altin Hazizaj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se për kandidatin Altin Hazizaj, si edhe për Gëzim Allaraj, Vladimir Gërmenji dhe, Eris Hysi dosjet na mbërritën dje dhe nuk patëm mundësi që të përfundonim shqyrtimin e dosjeve. Kështu që do të kërkonim për këta të katër mundësisht të kemi një kohë shtesë për dosjet e tyre.

**Margarita Buhali**, si relatore për kandidatin Altin Hazizaj në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në vijim të relatimit të mbledhjes së mëparshme vlerësoj të evidentojë që në rastin e kandidatit Altin Hazizaj ka pasur një problem të qartë dhe thelbësor me mënyrën se si ai vetë e ka plotësuar Deklaratën e Pasurisë për Kandidatët në Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë. Aty ka deklaruar vetëm të ardhurat e një viti, të vitit 2018.

**Ardian Dvorani** duke pasur parasysht që përfaqësuesi i Avokatit të Popullit rezervohet të shprehet për kandidatin Altin Hazizaj, i kërkon atij të parashtrojë mendimin lidhur me



procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatës Arta Vorpsi, e cila ka katër kandidime për vakancat në Gjykatën Kushtetuese.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se nga dokumentacioni që është përcjell, përtej atyre vërejtjeve dhe mungesave që kemi parashtruar më përpara në tërësi, e kemi të vështirë të japim një mendim përfundimtar. Në këtë rast janë kërkesat e KED drejtuar SHISH, AISM-së dhe Ministrisë së Brendshme. Sot në mbledhje u informuam që këto dokumente paskan ardhur por nuk na janë vënë në dispozicion. Ne kishim mbajtur shënim që këtyre dokumentave nuk u është kthyer përgjigje, prandaj do ta pyesnim KED pse për një dokument që e kanë cilësuar shumë të rëndësishëm kaë vazhduar më tej me procedimin dhe është konkluduar me relacionin për sa kohë që nuk u është kthyer përgjigje. Për ILDKPI-në e shprehëm problematikën, pra nuk dimë se si ka vepruar relatori për relacionin, cila është analiza e tij për marrjen parasysh ose jo, për rrëzimin ose pranimin e këtij relacioni dhe përsa i përket dokumentave personale. Dua të gjithë dokumentet që do të provonin plotësimin ose jo të kriterëve individuale që parashikon ligji. Për sa kohë këto dokumenta mungojnë, edhe ne i rekomandojmë organit që të kërkojë plotësimin e tyre. Për ta ilustruar, ligji thotë kandidati duhet të ketë notën mesataren mbi 8, duhet të ketë caq vjetërsi pune etj, etj. Mbi ç'bazë ka konkluduar relatori që të jetë plotësuar kriteri i vjetërsisë. Ne na mungon librezja e punës e kandidatit. Mund të thuhet që kandidati nuk solli librezë pune, solli vërtetim nga sigurimet shoqërore apo diçka tjetër. Pra, në vlerësimin tonë procedura nuk është e plotë për sa kohë nuk janë sjellë dokumentat të cilat provojnë plotësimin e kriterëve.

Ne kemi pasur një proces të ngjashëm për përzgjedhjen që i bëmë kandidateve për organet e vetingut. Pra, ligji na ngarkonte me detyrën për të bërë seleksionimin e kandidaturave. Për të orientuar kandidatët, si ne mendojmë që mund të provojë plotësimin e një kriteri bëmë një listë të dokumentave që duhet të plotësonte kandidati. Në rastin tuaj na rezulton që gati 50 % e këtyre dokumentave nuk janë në dosje. Kjo për ne është e lidhur drejtpërdrejt me procedurën. Për sa kohë që këto dokumenta mungojnë si do të provoj organit pa dokumenta plotësimin ose jo të një kriteri, edhe nëse ju thoni që këto dokumenta janë depozituar por ne nuk ja u kemi vënë në dispozicion.

**Anëtarët e Këshillit**, në lidhje me parashtrimet e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, jo thjesht për rastin e kandidatës Arta Vorpsi, por edhe në tërësi, në thelb, shprehin qëndrimin dhe i sjellin në vëmendje se relacionet përmbajnë në hollësi datën dhe numrin e shkresës së secilës përgjigje të dërguar pranë KED, por aty nuk përshkruhet përmbajta e përgjigjes. Nëse

vihet në dyshim vërtetësia e përmbajtjes së relacioneve, e veprimeve dhe fakteve të relatuar, këtë duhet ta deklaroni drejtpërsëdrejti. Po kështu KED nuk ka detyrim të listojë për kandidatët çfarë dokumentesh duhet të sjellin për të vërtetuar plotësimin e secilit kusht. Prezumimi është që ligjin e njohin dhe e zbatojnë të gjithë njësoj. Aq më tepër kjo për ata që pretendojnë të jenë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Nëse dokumentet e paraqitura nga kandidatët janë të mjaftueshme për plotësimin e një kriteri kjo lidhet me vendimmarrjen e Këshillit sipas ligjit në fund të procesit por jo me procedurën e tanishme deri në relativim.

Nga ana tjetër pretendohet të shikohen në relacion gjetje juve t'ju krijojë përshtypjen e qartë nëse Këshilli propozon lejimin ose ndalimin e kandidimit. Por duhet të mbahet parasysh specifika e procedurës sonë ku secili prej relatorëve është dhe anëtar i Këshillit pjesë e trupës vendimmarrëse. Relacionin e bën një anëtar i cili do të jetë dhe pjesëtar i trupës që do të marrë vendim. Për të mos u vënë në kushtet e dhënies së vendimit dhe të shfaqjes së mendimit paraprakisht e që mundet, me te drejtë, të shqetësojë një kandidat dhe të pretendojë se relatori e ka të shfaqur mendimin negativ ose pozitiv për mua etj, për ti paraprirë kësaj situatë në relacion nuk shfaqet ndonjë përfundim paraprak nëse lejohet ose ndalohet kandidimi por bëhet përshkrimi i hapave proceduralë. Avokatit të Popullit i është vënë në dispozicion edhe dokumentacioni, po kështu kandidatët kanë akses të plotë paraprak në to. Për të gjitha këto veprime, për analizën mbi plotësimin ose jo të kriterëve dhe arsyetimin përkatës, të gjithë, kandidatët, Avokati i Popullit, vëzhguesit e tjerë dhe publiku do të njihen me vendimin që shpallet publikisht dhe i arsyetuar.

**Ardian Dvorani**, i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të parashtrorë mendimin lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit Ded Kasneci, i cili ka tre kandidime për vakancat në Gjykatën Kushtetuese.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se në dokumentacionin e kandidatit Ded Kasneci janë pak a shumë të njëjtat probleme. Pra, për të mos i përsëritur, po ato që ishin edhe tek zonja Vorpsi, informacioni nga SHISH, AISM, Ministria e Brëndshme, nga ish Sigurimi i Shtetit, edhe nga ILDKPI-ja që na i keni dhënë me CD por nuk ishte tek dokumentacioni i përcjellë në rrugë shkresore. Njëkohësisht kemi bërë edhe disa tabela të veçanta për çdo kandidat për dokumentat që thamë si liberza e punës, dokumenta personale që lidhen me arsimin dhe përvojën. Duhet të verifikohet gjendja penale e personit për periudhën që ka qëndruar rreth 5 vjet jashtë vendit. Duhet parë me kujdes çështja e vjetërsisë dhe e përvojës në punë si dhe

pozicioni i punës në përmbushjen e kritereve të përcaktuara për kandidatë për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

*Ardian Dvorani*, i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të parashtrojë mendimin lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidates Elsa Toska, e cila ka katër kandidime për vakancat në Gjykatën Kushtetuese.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashton se në dokumentacionin e kandidates Elsa Toska na mungon informacioni i sjellë nga AISM, SHISH-i, Ministria e Brendshme. Përsa i përket dokumentave që lidhet me kriterin e vjetërsisë duke qenë se kandidatja ka qenë edhe ish punonjëse e institucionit tonë, kemi nisur verifikimin për plotësimin e kriterit të vjetërsisë 15 vjet sipas ligjit.

Ka edhe çështje që nuk janë plotësisht të qarta për institucionin tonë. Neni 7/a pika 2, gërma “a” përcakton që kandidati të ketë përvojë punë jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, profesor ose lektor i së drejtës.

Për rastin konkret, është çështja e “specialistit të lartë”, “jurist i nivelit të lartë në administratë publike”. Terminologjia e përdorur nga kjo pikë pra jurist i nivelit të lartë në administratën publike i referohet legjislacionit ekzistues. Ndërkohë që bëhet fjalë për kandidatë që kanë 10 – 15 – 20 vjet dhe legjislacioni i atëhershëm nuk e përmendte, nuk bënte këtë lloj ndarje. Kandidatja ka qenë me kontratë pune, fillimisht kur ka ardhur në institucionin e Avokatit të Popullit në 28.08.2000. Nga koha e shkurtër nuk e shqyrtuam gjithë dokumentacionin vijues kur kjo candidate u kthye në nëpunës civil. A do të jetë ky nëpunës civil i nivelit të lartë apo jo? Duhet të shikohet VKM-ja e kohës sepse aktet normative të tanishme kanë tjetër terminologji ligjore. Çështje tjetër këtu është që ndryshe është të kesh qenë lektor dhe ndryshe pedagog. Në relacionet përmendet fjala herë pedagogë dhe herë lektor. Jo të gjithë pedagogët janë lektor. Ka që merren me seminarët, ka që merren me çështje të tjera të administratës.

Po kështu, jo vetëm për kandidaten Toska, por edhe për kandidatët e tjerë nuk na rezultojnë në dosje ti jenë drejtuar punëdhënësit të fundit për masat disiplinore që mund të kenë pasur. Për këta që kanë qenë në Gjykatën Kushtetuese ka një komunikim të tillë dhe ka ardhur përgjigjë nga Gjykata Kushtetuese. Ndërkohë, nuk na është vënë në dispozicion përgjigja edhe për çështjeve e masave disiplinore për kandidatë të tjerë. Kjo duhet të jetë duke padur parasysh legjislacionin në fuqi që masat disiplinore parashkruhen. Përveç

vetëdeklarimit që ka bërë çdo kandidat në vlerësimin tonë do të duhej të komunikohet shkresërisht me punëdhënësin e fundit të kandidatëve.

Një çështje tjetër është edhe vlerësimin e punëdhënësit që nuk patëm mundësi të verifikonim legjislacionin, pra ka apo nuk ka legjislacion që parashikon vlerësimin e personave që nuk janë pjesë e administratës publike. Këto vlerësime mungojnë në relacione. Kjo ishte e përgjithshme.

**Ardian Dvorani**, pasi *anëtarët e Këshillit* bëjnë të qartë se kërkesat për informacion dhe përgjigjet lidhur me masat disiplinore janë realizuar, si edhe që çështjet e vlerësimit lidhen me fazën tjetër të vlerësimit dhe jo me verifikimin, i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të parashtrijë mendimin lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatës Fiona Papajorgji, e cila ka tre kandidime për vakancat në Gjykatën Kushtetuese.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se për zonjën Papajorgji, pak a shumë janë të njëjtat gjëra si edhe për kandidatët e tjerë. Pra, mungojnë nga Ministria e Brendshme, AISM-ja, SHISH, jo të gjitha partitë politike kjo si për të gjithë kandidatët. Na mungon dokumentacioni bashkangjitur i KQZ-së për të parë çfarë liste kanë sjellë. Po kështu përgjigja, vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme për çështjen e dekriminalizimit. Këtu përmendet vendimi por nuk është shkresa përcjellëse. Për znj. Papajorgji janë 12 dokumente në italisht të cilat nuk janë të përkthyer. Edhe tek disa kandidatë të tjerë ka dokumente në gjuhë të huaj. Ka dokumente bankare rreth 100 faqe të znj. Papajorgji kur ka qenë jashtë. Pra ka dokumenta që nuk janë përkthyer dhe në rregullorë është parashikuar që dokumentat e paraqitura të jenë origjinale ose të vërtetuara njësia me origjinalin, njëkohësisht duhet të jenë në gjuhën shqipe.. Për znj. Papajorgji rekomandojmë një hetim më të thelluar në lidhje me gjendjen penale për periudhën që ka jetuar jashtë shtetit. Gjithashtu rezulton e paqartë se kur KED i është drejtuar ILDKPI-së për kandidaten janë edhe personat e lidhur të subjekteve por nuk na rezulton si KED-ja i ka evidentuar këta persona të lidhur.

**Ardian Dvorani**, pasi *anëtarët e Këshillit* ndër të tjera i bëjnë të qartë se identitetet e personave të lidhur janë të identifikuar saktësisht nga procedura e plotësimit të deklarimeve paraprake të kandidatëve pranë Këshillit sipas rregullave të procedurës, i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit të parashtrijë mendimin lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit Vladimir Gërmenji, i cila ka dy kandidime për vakancat në Gjykatën Kushtetuese.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ky është një nga rastet e tjera kur dokumentacioni ka ardhur një ditë para mbledhjes dhe nuk patëm mundësi që të përfundonim shqyrtimin e dosjeve. Për të shprehur dhe gadishmërinë tonë që mos të paragjykohehi, sapo të zbardhen shënime mbi dosjet e shqyrtuara jemi të gatshëm që me shkrim ti përcjellim zyrtarisht mendimet.

**Ardian Dvorani**, duke e njoftuar se mendimet me shkrim mund të dërgohen në kushtet kur vendimmarrja, zbardhja dhe publikimi me kujdesin e akronimit të disa të dhënva sipas ligjit kërkojnë disa ditë kohë, i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Mustafaj.

**Arta Marku**, parashtron relatimin për kandidatin Ilir Mustafaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se siç deklaroam edhe në fillim të mbledhjes për ata kandidatë që janë rrëzuar nga KPK-ja dhe janë në pritje të shqyrtimit në shkallën më të lartë, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të mos vazhdoj më tej procedura nga KED.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Mustafaj.

**Eriol Roshi**, parashtron relatimin për kandidatin Ilir Mustafaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ka të njëjtin qëndrim.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Mustafaj.

**Fatri Islamaj**, parashtron relatimin për kandidatin Ilir Mustafaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 04.03.2019.

**Ardian Dvorani** pyet anëtares nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se ka të njëjtin qëndrim.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Ilir Mustafaj.

*Fatjona Memçaj*, parashtrohet relativisht për kandidatin Ilir Mustafaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se ka të njëjtin qëndrim.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Anila Guri (Kristani).

*Vitore Tusha*, parashtrohet relativisht për kandidaten Anila Guri (Kristani) për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se mbështesim relacionin dhe ka të njëjtin qëndrim si në rastin e kandidatit Ilir Mustafaj.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj.

*Margarita Buhali*, parashtrohet relativisht për kandidatin Artur Malaj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se e përmendëm në fillim të mbledhjes qëndrimin tonë për këtë rast. Në vlerësimin tonë çështja duhet pezulluar për disa arsye. *Së pari*, ka një legjislacion specifik që është ligji “Për Gjykatën Kushtetuese” i cili në nenin 7/a pika 1 gërma dh përcakton “*të ketë*

*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve sipas ligjit*". Pra procesi i kontrollit nuk duhet të kufizohet vetëm në KPK por përfshin të gjithë procesin. *Së dyti*, ka një anë morale. Ankimi i Komisionerit Publik, një institucioni kaq të rëndësishëm. Edhe kur një qytetar bën një informacion, organi ka detyrimin ta verifikojë jo më në rastin kur ndodhemi përpara një ankimi që ka bërë Komisioneri Publik. *Së treti*, si kanë proceduar organet e tjera. Ndryshe nga ju organet e tjera kanë stopuar procesin në pritje të përfundimit procesit të vetingut. Dhe *së fundi* për të gjitha këto arsye që përmenda më sipër mendojmë që konform nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative të pezullohet procedura e verifikimit. Javën e kaluar ka pasur një seancë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Komisioneri Publik depozitoi ankim shtesë që u pranua nga Kolegji dhe për shkak të pyetjeve që bëri trupi gjykues u la seanca e rradhës në datën 3 shtator. Nisemi edhe nga eksperiencia të mëparshme, siç ishte rasti i anëtarit të Gjykatës së Lartë z. Edmond Islamaj i cili kishte një vendim pozitiv nga KPK-ja por që pati një vendim negativ nga KPA-ja.

**Ardian Dvorani**, pasi **anëtarja relatorë** solli në vëmendje se neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 është ligj i posaçëm për kandidatët në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk ka lidhje me rastin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastet e kandidimit të kandidatit Besnik Muçi.

**Eriol Roshi**, parashtron relatimin për kandidatin Besnik Muçi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se edhe në këtë rast kanë të njëjtin qëndrim si për rastin e kandidimit të z. Artur Malaj.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatore Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Besnik Muçi.

**Arta Marku**, parashtron relatimin për kandidatin Besnik Muçi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se edhe në këtë rast kanë të njëjtin qëndrim si për rastin e kandidimit të z. Artur Malaj.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Besnik Muçi.

**Vitore Tusha**, parashtron relatimin për kandidatin Besnik Muçi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se edhe në këtë rast kanë të njëjtin qëndrim si për rastin e kandidimit të z. Artur Malaj.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates regleta Panajoti.

**Arta Marku**, parashtron relatimin për kandidaten Regleta Panajoti për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se siç u parashtrua edhe në relacion, nuk ka përfunduar ende periudha brenda të cilës Komisioneri Publik të vendosë nëse do të bëjë apo jo ankim ndaj vendimit të KPK, pra nuk ka marrë formë të prerë. Kështu që ne i mbetemi të njëjtit qëndrim si për kandidatët Malaj dhe Muçi. Pra të pezullohet shqyrtimi deri në përfundimit të afatit që ka Komisioneri për të bërë ankim.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Regleta Panajoti.

**Eriol Roshi**, parashtron relatimin për kandidates Regleta Panajoti për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.



*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashton se ka të njëjtin qëndrim.

*Këshilli* ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

## PJESA E DYTË E MBLEDHJES

*Mbledhja e Këshillit*, pas pushimit, vijon me shqyrtimin e gjetjeve në procedurat e verifikimit të disa kandidatëve të tjerë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Mimoza Qinami.

*Margarita Buhali*, parashton relativimin për kandidaten Mimoza Qinami për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashton se nga shqyrtimi i dosjes së kandidates na rezulton që nuk ka dokumentacion të plotë që vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të parashikuara nga neni 7/a i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu na rezulton që mungojnë përgjigjet e institucioneve në dosjen që na ka vënë në dispozicion KED. Mungon në dosje përgjigja nga AIDSSH, SHISH, Ministria e Brendshme, OSHEE, jo të gjitha partitë politike. Gjithashtu aty mungon dokumentacion personal i tillë si diploma, si librezë e punës, vërtetime të tjera që provojnë plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuar në Ligjin nr.115/2016 për pozicionin e ILD apo neni 7/a i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Kështu ka mangësi në dokumente që të mund të nxirrim konkluzione për procedurat ndjekura deri në këtë fazë.

*Ardian Dvorani*, duke shpjeguar paraprakisht se, për një pjesë të rasteve të kandidimeve, dokumentacioni i dërguar Avokates së Popullit, në pjesën e përgjigjeve, është i kufizuar vetëm në një aspekt edhe për shkakun se sipas rregullave të procedurës kur relatori vëren gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit për një shkak të caktuar ligjor e përcjell

çështjen në mbledhjen e Këshillit pa qenë e nevojshme të përfundojnë procedurat e verifikimit për kushtet e tjera të kandidimit, i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastet e kandidimit të kandidatës Mimoza Qinami.

**Fatri Islamaj**, parashtrohet relatimin për kandidaten Mimoza Qinami për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 04.03.2019.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se i mbetemi të njëjtave sqarime dhe shpjegime për kandidimin e mëparshëm.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj.

**Eriol Roshi**, parashtrohet relatimin për kandidatit Gëzim Allaraj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se edhe në këtë rast për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion nuk patëm mundësi të njihemi me dosjen e tij.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj.

**Vitore Tusha**, parashtrohet relatimin për kandidatin Gëzim Allaraj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se edhe në këtë rast kanë të njëjtin qëndrim si në rastin e parë.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Gëzim Allaraj.

**Arta Marku** parashtron relatimin për kandidatin Gëzim Allaraj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se edhe në këtë rast kanë të njëjtin qëndrim si në rastin e parë.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatore Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Eris Hysi.

**Margarita Buhali**, parashtron relatimin për kandidaten Eris Hysi për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se edhe ky rast është ndërmjet dosjeve që kanë ardhur së fundmi. Por në një vështrim të parë, konstatoam kërkitime të përsëritur shpjegimesh nga relatori gjë që nuk na del e sqaruar qartë në relacion. Gjithmonë në lidhje me procedurën, kjo tek pika 32 dhe pika 33. N kemi ngritur që në fillim pyetjen si mendon KED të veprime në lidhje me 11 opinionet negative që ka dhënë ILDKPI-ja. Jo vetëm sepse kjo lidhet me procedurën, pra a do të caktojë ekspert, do tja kërkojë ILDKPI-së prapë mendimin apo jo. Edhe për relacionet ILDKPI-së, KED ka të drejtë që të japë një mendim kundër gjë që ka ndodhur siç thashë me KPK. Edhe kur relacioni i ILDKP ka qene pozitiv apo negativ ato nuk e kanë marrë parasysh. Në rastin konkret nuk kemi ende një mendim të plotë por qoftë në parim do të donim të kishim më shumë informacion nga KED.

**Ardian Dvorani** relaton rastin tjetër të kandidimit të kandidatës Fiona Papajorgji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018. Ky rast është shqyrtuar në mbledhjen e mëparshme por gjatë bisedimit të çështjes Këshilli konstatoi edhe një moment e rrethanë që mund të përbejë shkak për ndalimin e kandidimit të saj vetëm për këtë pozicion. Kjo mbështetet tek pika 48 vendimit nr. 4/2019 të KED sipas të cilit, nëse relatohet çështja në Këshill dhe paraprakisht nuk mendohej se ka gjetje që mund të sjellin ndalim kandidimi, por nga bisedimi i çështjes mund të rezultojë probleme të kësaj natyre, atëherë nuk merret vendim por njoftohet kandidati për problemin, kërkohen shpjegime dhe dokumentacion përkatës dhe më pas

çështje rishqyrtohet në mbledhjen e Këshillit. Kjo ka ndodhur edhe në rastin konkret. U evidentuan disa rrethana që mund të sjellin ndalimin e kandidimit vetëm për këtë vakancë në lidhjes me plotësimin e kushtit ligjor të vjetërsisë në profesion.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Enio Haxhimihali*, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ndajmë eksperiencën që kemi pasur si Avokat i Popullit në shqyrtimin kandidaturave për organet e vetingut. Kemi pasur raste se ku sipas legjislacionit shqiptar asistent/avokati ka pozicion dhe të tjera detyrime, ndërsa sipas legjislacionit italian e zviceran parashikohet që zyra avokatore për të duhet të paguajë sigurime, tatime, të regjistrohet dhe i njihet për efekt vjetërsie në profesion.

*Këshilli vijon mbledhjen* me pikën tjetër të rendit të ditës, caktimin e audituesit ligjor të licencuar për dhënien e mendimit teknik lidhur me analizën financiare të nevojshme për disa aspekte të verifikimit të pasurisë të kandidatës Zhaklina Peto.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtarëve relatorë Arta Marku dhe Eriol Roshi të relatojnë rrethanat dhe motivet për nevojën e caktimit të ekspertit auditues ligjor për rastin e kandidatës Zhaklina Peto, e kandiduar për dy vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, njëra e plotë dhe tjetra e parakohshme, të dyja të shpallura në datën 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

*Arta Marku dhe Eriol Roshi* parashtrojnë relatimet përkatëse për rrethanat dhe motivet që, pas administrimit të raportit të ardhur nga ILDKPI-ja dhe shpjegimeve e dokumenteve kundërshtuese të sjella nga kandidatja, rezulton që nuk ka probleme ligjore, por çështje të mirëfillta financiare në lidhje me pasurinë e saj. Kjo e bën të nevojshme realizimin e një analize financiare për justifikimin e burimeve të ligjshme të pasurisë së kandidatës Zhaklina Peto dhe për realizimin e këtij veprimi nëpërmjet caktimit të një audituesi ligjor.

Gjithashtu, relatorët, bazuar në veprimet dhe dokumentet që disponohen, si edhe nga lista e ekspertëve kontabël të autorizuar, i propozojnë Këshillit që si ekspert auditues ligjor të jetë z. Arqile Mishtaku.

*Ardian Dvorani*, merr fjalën dhe shpjegon në thelb se është i njohur me përpjekjet e relatorëve për gjetjen e ekspertit dhe është në dijeni të vështirësive. Fillimisht është kontaktuar KPK zyrtarisht nëse shikonin mundësinë për të vënë një ose dy nga këshilltarët e tyre ligjore ekonomike për ti caktuar si ekspertë për analizat tona financiare. KPK ka shprehur mirëkuptimin për nismën por e kanë të pamundur vënien në dispozicion të

personelit të tyre. Gjithashtu, rezulton e vështirë jo sepse nuk ka ekspertë por duke qenë se i përmbahemi tarifave publike, jo të gjithë ata të kontaktuar të gatshëm ta bëjnë këtë detyrë. Eksperti që propozohet nga relatorët, ishte një rast që është dakortësuar me personin dhe nëse e miraton këshilli, ka lënë kontaktet e veta në mënyrë që të fillojë punë menjëherë. Pasi miratohet nga Këshilli, relatori i përcjell ekspertit detyrat që duhet të realizojë dhe identitetin e kandidatit për të verifikuar mundësinë e konfliktit të interesit. Njësoj informohet kandidatja për identitetin e ekspertit.

*Anëtarët e Këshillit* miratojnë si ekspert për këtë rasti kandidimi propozimin e relatorëve për zotin Arqile Mishtaku.

*Ardian Dvorani* i kërkon Bledar Dervishaj të parashtojë mendimet përpara Këshillit sipas kërkesës së tij dërguar paraprakisht me email, për të cilën Këshilli u dakordësua në fillim të kësaj mbledhje kur miratoj rendin e ditës.

*Bledar Dervishaj* merr fjalën dhe parashtron se tashmë Këshilli ka kaluar në procesin shqyrtues të kandidaturave. Sipas rregullave të miratuara nga Këshilli, të ftuarit ose institucionet e ftuar sipas ligjit, Kuvendi, Presidenti apo edhe Gjykata e Lartë nuk kanë të drejtën e fjalës e të komentojnë. Kështu që çështjet që do të ngre, mund ti paraqes jashtë momentit kur shqyrtohen kandidaturat apo relatohen ato. Prandaj kërkova me këtë email për ta marrë fjalën në këtë mbledhje. Shumë mirë e gjykuat që të ishte në fund pasi është mbaruar relatimi i të gjitha gjetjeve mbi 12 apo 13 kandidatëve që u shqyrtuan sot.

Ajo që unë do të dëshiroja të evidentoja për Këshillin nuk është se janë çështje të reja. Janë sërish ato çështje që në mënyrë të vazhduar kemi prej 7 muajsh që i kemi ngritur, rekomanduar e sugjeruar Këshillit për të pasur një vlerësim të kujdesshëm, njëra prej të cilave u ngrit edhe nga Avokati i Popullit, nga përfaqësuesi i tij në mbledhjen e sotme. Por përpara se të kaloj aty do të bëj një përshkrim kronologjik se çfarë ka ndodhur, shumë të shkurtër.

Pra, ky Këshill po qëndron i mbledhur prej 7 muajsh, po shqyrton 6 vakanca, një tërësi kandidaturash të paraqitura prej tyre. Në mbledhjet e kaluara, edhe në mars edhe në qershor, Institucioni i Presidentit ka ngritur shqetësimin, problemin e rivlerësimit kalimtar të atyre kandidateve që vijnë nga gjyqësori dhe prokuroria apo janë subjekte vlerësimi. Kemi mbajtur qëndrimin parimor kushtetues se një kandidat i suksesshëm i listuar nga Këshilli për organin e emërtesës, nëse është subjekt i rivlerësimit, duhet të ketë kaluar këtë proces me vendim përfundimtar të formës së prerë. Ky është qëndrimi që kemi mbajtur në vijimësi. Është reklamuar nga ju edhe në mbledhjet e tjera, edhe sot u tha që është emergjenca e Gjykatës Kushtetuese. Po pse Presidenti i Republikës që bën këtë kërkim në mënyrë të vazhduar nuk e njeh këtë emergjencë? Patjetër që e njeh shumë mire sepse është një nga

organet e emërtesës që ka publikuar e shpallur vakancën e parë në datën 07.02.2018, i ka publikuar, i ka administruar dhe në 27-28 shkurt 2018 i ka bërë shkresë këtij Këshilli duke i thënë aplikuan 22 për një të vakancë dhe 15 për vakancën tjetër. Kjo është lista, kërkoj mbledhjen dhe administrimin e tyre. Këshilli u mbledh në datën 19 mars 2018, bëri një mbledhje, ishin përfaqësues të Kuvendit, të Presidentit, ishte i gjithë Këshilli dhe u vendos të administrohen dokumentet, listat dhe të punohet më miratimin akteve nënligjore. Mbledhja e parë dhe fundit e atij Këshilli. U shpall vakanca tjetër e znj. Altina Xhoxhaj, e shkarkuar në Maj 2018, me vendim të formës së prerë Tetor 2018. U shpall menjëherë brenda 7 ditëve, sërish Këshillit ju dërguan listat e atyre që aplikuan, 3 aplikante. Rilindi kjo vakancë për shkak se ky Këshill nuk mund të administrojë 3 kandidatura të përshtatshme brenda afatit kohor. Pas njoftimit, brenda 6 ditësh, u publikua vakanca, u administruan dhe u sollën kandidaturat dhe sot të paktën nga gjetjet rekomanduan sot, duket se rezultojnë që kanë ngjitur 12 kandidate për 6 vakanca.

Aty, në vlerësimin tim dy janë magistratë, prokuror dhe gjyqtarë. Po flas për Gjykatën Kushtetuese dhe po e lë mënjane ILD. Nëri me vendim pozitiv nga KPK dhe tjetri po vendim të KPK pozitiv por që pritet të zbardhet vendimi. Nëse nesër zbardhet vendimi pritet a do ti bëhet ankimi deri në datën 8 gusht, sipas ligjit. Lind pyetja, po mirë nuk pati kjo KPK apo Kolegji i Posaçëm i Apelit gjithë këtë kohë që ti shqyrtonte me prioritet këto? A nuk ishte situatë emergjente këtu edhe 6 muaj më përpara? Këtu e 14 muaj me përpara? Kur humbi kuorumin Gjykata Kushtetuese për të marrë në shqyrtim ligjet, flas jo për pjesën tjetër. Në tetor kur u shpall vakanca tjetër, edhe në 15 Janar kur filluat ju si Këshill punën? Kanë ikur 7 dhe nuk patëm një kohë të merreshin ato në shqyrtim që sot të mos lindte ky diskutim? Koha ka qenë mjaftueshme dhe ngritja e këtij pretendimi nuk na inkurajon ose nuk na jep frikën se po bllokojmë procesin. Ne nuk po bllokojmë procesin. Ne po kërkojmë atë që është në vlerësimin tonë kushtetues. Nuk është drejtë dhe nuk është se mirëpresim të listuar kandidatë për në Gjykatën Kushtetuese kur ligji dikton se s'bën të zgjedhësh një magistrat me vendim të formës së prerë. Prandaj e mbështes kërkesën e Avokatit të Popullit si një formë apo mjet që është pezullimi i procesit, ashtu sikurse kemi kërkuar në formën tjetër, atë të rishikimit të aktit nënligjor të KED. Edhe SPAK ka emergjencë, e kërkojnë të gjithë ngritjen por me vendime të formës së prerë.

Ne kemi ndjekur me vëmendje të gjithë zhvillimet, për të gjithë organet. Shikojmë se si zhvillohet procedura në KLP. Ato listuan dhe presin vendimin e Kolegjit për të gjithë kandidatët e SPAK. Por si ka mundësi që të vijmë tek Gjykata Kushtetuese, organi më i lartë kushtetues që vendos mbi gjëra të rëndësishme se si organizohet e vepron ky shtet dhe të

zgjedhë organi i emërtesës një kandidat që nuk ka mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar? Nuk është e vërtetë që ligji lë vend për interpretim. Procesi i rivlerësimit kalimtar, e thotë ligji për Gjykatën Kushtetuese, duhet të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit për vete dhe për familjarët. Ato që e kanë hartuar kanë qenë goxha të mirëmenduar sepse ka kandidatë nga jashtë dhe nga brenda sistemit. Sipas dispozitave të Kushtetutës procesi përmbillet kur ka një vendim të Kolegjit të Apelit. Prandaj pa zgatur me tutje do të kërkoja Këshillit edhe njëherë vlerësimin me shume prioritet të të gjitha gjetjeve të Avokatit të Popullit, shqyrtimin edhe të këtij rekomandimi që unë e përsëris për të disatën herë në emër të Institucionit të Presidentit të Republikës.

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

#### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 20.04**

**Sekretare**

**Ermelinda Kadiu**

**Redjona Myrtja**

**Dorina Dulaj**

**Kryetari**

**Ardian Dvorani**